

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zjarri përfshin sërish shtëpinë e Vudi Xhymshitit, gazetari kërkon hetim dhe ngre dyshime për lidhje me p unën e tij
ADRESA	https://albeu.com/kosove/zjarri-perfshin-serish-shtepine-e-vudi-xhymshitit-gazetari-kerk on-hetim-dhe-ngre-dyshime-per-lidhje-me-punen-e-tij/1030083/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:41:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:35:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	18976d59c866f654bf417fa736fd3cecad07acd48793ce0f9c7286f5f5b7a0ec
TEKSTI	6284bc4e62e45953127ef260f17dbd73bb38d4b262da1ebda8b6c301f9db4086
PAMJA	4432431199bfb551c9cbd1583370be95615a5c47795a6cb84f4c52327d1098ed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2296135f13773bf4475f13eee2ff597c0bc88a36d3f5a32aa3be7030ae226666
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2296135f13773bf4475f13eee2ff597c0bc88a36d3f5a32aa3be7030ae226666

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Zjarri përfshin sërish shtëpinë e Vudi Xhymshitit, gazetari kërkon hetim dhe ngre dyshime për lidhje me punën e tij



Shtëpia e prindërve të ndjerë të gazetarit investigativ Vudi Xhymshiti është djegur sërish, ndërsa ai dyshon se ngjarja mund të ketë lidhje me veprimtarinë e tij profesionale. Xhymshiti, i cili ka mbajtur qëndrime kritike ndaj figurave dhe grupeve politike të lidhura me PDK-në dhe AAK-në, u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që ta hetojnë plotësisht rastin.

Zjarri ka përfshirë shtëpinë e familjes së gazetarit në fshatin Livoçë në Ulët të Gjilanit dhe ka shkaktuar dëme materiale. Rasti është raportuar në Policinë e Kosovës më 26 shtator 2026, ndërsa ende nuk dihet saktësisht se kur ka nisur zjarri dhe cilat kanë qenë rrethanat e tij.

Interesimi për rastin është shtuar pas reagimit të Xhymshitit, i cili ka kujtuar se e njëjta banesë ishte djegur edhe në vitin 1999, gjatë luftës në Kosovë. Sipas dëshmisë së tij, atëherë zjarri ishte shkaktuar nga forcat serbe të regjimit të Slllobodan Millosheviqit.

Gazetari ka shprehur dyshimin se incidenti i fundit mund të jetë i ndërlidhur me punën e tij në gazetari, si dhe me kërcënimet e presionet publike që thotë se i ka përjetuar më herët.

Xhymshiti: Pres përgjigje nga institucionet

Përmes një reagimi në Facebook, Xhymshiti ka folur për shqetësimin e tij lidhur me sigurinë dhe ka kërkuar nga autoritetet që të zbardhin plotësisht rrethanat e ngjarjes.

Ai ka theksuar se nuk dëshiron të fajësojë askënd për zjarrin pa prova konkrete. Megjithatë, gazetari ka përmendur persona që, sipas tij, kanë nxitur një atmosferë urrejtjeje dhe linçimi ndaj tij.

të fundit



Kontrolle në veri të Kosovës, sekuestrohen armë, municion dhe...



Përfundojnë fjalimet para Kryeministritë, protestuesit marshojnë...



Këlliçi akuzon Ramën pas kthimit nga SHBA: "Kryehajdut i..."



Vedat Muriqi merr përgjegjësinë pas humbjes me Austrinë:...



Volkswagen zgjeron hapësirën e ngarkesës te furgoni elektrik ID:...



Atmosferë e tensionuar para Irlandë-Izrael: futbollistët irlandezë:...



Mijëra persona në Prishtinë në tubim përkaish:...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ne deklaruar e u janë përmendur Hysni Gucau, drejtues i veteraneve të luftës, zyrtari i PDK-së Elmi Reçica dhe Dardan Krasniqi, të cilin Xhymshiti e identifikon si përfaqësues të AAK-së.

Xhymshiti i ka kritikuar këta persona për deklarata dhe qëndrime publike që, sipas tij, kanë ndikuar në shënjestrimin e tij për shkak të punës që bën si gazetar.

Megjithatë, ai nuk ka deklaruar se posedon prova që ndonjëri prej personave të përmendur të ketë marrë pjesë në shkaktimin e zjarrit.

Duke e lidhur rastin e fundit me djegien e shtëpisë gjatë luftës, gazetari ka thënë se përdorimi i frikës për t'i mbyllur gojën medias përbën rrezik serioz.

Reagimin e tij e ka mbyllur me zotimin se do të vazhdojë punën dhe me kërkesën që institucionet kosovare të japin përgjigje për atë që ka ndodhur.

Qëndrimet e tij ndaj PDK-së dhe AAK-së

Vudi Xhymshiti është themelues dhe kryeredaktor i Frontline Media Group. Përmes punës së tij, ai ka raportuar për tema të ndjeshme politike dhe historike, përfshirë luftën në Kosovë, krimet e luftës, vrasjet politike dhe proceset gjyqësore në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Ai është bërë i njohur edhe për kritikën ndaj figurave dhe grupeve politike që lidhen me PDK-në dhe AAK-në, veçanërisht në çështje që kanë të bëjnë me përgjegjësinë për krimet e luftës dhe mënyrën e trajtimit të kundërshtarëve politikë.

Xhymshiti ka deklaruar më herët se nuk është pjesë e asnjë partie politike dhe se qëndrimet e tij burojnë nga angazhimi i tij profesional në gazetari.

Përplasjet publike me përfaqësues politikë kanë kaluar edhe në procedura ligjore. Në qershor të këtij viti, Elmi Reçica bëri të ditur se kishte ngritur padi civile dhe kishte dorëzuar kallëzim penal ndaj Xhymshitit. Reçica e akuzoi gazetarin për deklarata të pavërteta dhe mesazhe kërcënuese ndaj tij dhe familjes së tij. Këto mbeten pretendime të Reçicës dhe nuk përbëjnë përfundime gjyqësore.

Përplasjet e mëparshme dhe incidenti në Hagë

Djegia e shtëpisë është raportuar pas një serie incidentesh dhe kërcënimesh të bëra publike nga gazetari dhe organizata ku ai vepron.

Më 16 shtator, Frontline Media Group njoftoi se Xhymshiti dhe redaktori politik Michael Sheppard ishin shtyrë dhe kërcënuar gjatë raportimit pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. Sipas organizatës, situata kishte kërkuar ndërhyrjen e policisë holandeze.

Frontline Media Group ka thënë gjithashtu se pas incidentit, në rrjetet sociale ishte publikuar një video me kërcënime ndaj Vudi Xhymshitit dhe ministres Donika Gërvalla.

Në një deklaratë të publikuar më 27 shtator, organizata bëri të ditur se Policia kishte ndaluar një person, i dyshuar për kanosje në lidhje me videon.

Organizata ka kërkuar që këto episode të përfshihen në shqyrtimin e përgjithshëm të rastit të zjarrit, por ka sqaruar se deri tani nuk ka prova që dëshmojnë lidhje mes tyre.

Policia e trajton rastin si zjarrvëniet e mundshme

Policia e Kosovës ka konfirmuar se më 26 shtator, rreth orës 15:45, ka marrë njoftim për zjarrin në një shtëpi në Livoç të Ulët.

Sipas të dhënave të policisë, dëmet janë shkakuar në bodrumin e objektit, ku ndodheshin një veturë, pajisje pune dhe orendi shtëpiake.

Objekti nuk ishte i banuar dhe autoritetet ende nuk kanë arritur ta përcaktojnë kohën kur kishte ndodhur zjarri.

Në vendin e ngjarjes kanë punuar hetues policorë, njësitet e Krimteknikës Rajonale dhe eksperti i zjarreve.

Pas konsultimit me Prokurorin e Shtetit, rasti është regjistruar për hetime në drejtim të veprës penale të zjarrvënies. Shkaku i zjarrit ende nuk është përcaktuar.

Kërkohet shqyrtimi i të gjitha zhvillimeve

Frontline Media Group, në reagimin e publikuar të dielën, më 27 shtator, u ka kërkuar institucioneve të Kosovës që hetimi të mos përqendrohet vetëm te dëmet materiale të shkaktuara në shtëpi.

Sipas organizatës, duhet të përcaktohet koha e saktë e shpërthimit të zjarrit, të analizohen provat teknike dhe të shqyrtohet mundësia e ndonjë lidhjeje me kërcënimet e mëparshme ndaj gazetarit.

Frontline Media Group ka deklaruar se është e gatshme t'ua dorëzojë hetuesve materialet që ka ruajtur për kërcënimet dhe shënjestrimin e pretenduar të Xhymshitit.

Njëkohësisht, organizata ka bërë të qartë se nuk e di se kush e ka shkakuar zjarrin dhe se nuk përjashton asnjë version që mund të mbështetet nga rezultatet e ekspertizës.

Rasti ka rrikthyer në vëmendje çështjen e sigurisë së gazetarëve dhe mënyrën se si institucionet reagojnë ndaj kërcënimeve që mund të lidhen me ushtrimin e profesionit.

Përfundimi nëse zjarri ishte i qëllimshëm dhe nëse ekziston ndonjë lidhje me punën e Vudi Xhymshitit mbetet në dorë të organeve hetimore.

Shtuar më 27.09.2026 21:35

Tags: Digjet sërish , shtëpia e gazetarit , Vudi Xhymshiti



Kontrolle në veri të Kosovës, sekuestrohen armë, municion dhe pajisj...



Mijëra persona në Prishtinë në tubim përkrah ish-udhëheqësve të UÇK-së



Zgjedhja e Presidentit e vendos Kosovën përballë rrezikut të një krize të re...



Arrestimet e veteranëve në Maqedoninë e Veriut, kërkohet reagimi i...



Hamza largohet nga Qeveria pas takimit me Kurtin, pa bërë të ditura...



Kurti zhvillon takim me Hamzën para seancës së Kuvendit



Pas 27 vitesh, identifikohen me ADN tri viktime të "Grupit të Intelektualëve t...



Bekteshi reagon ashpër ndaj Ramës: Tërbimi në Nju Jork dhe përdorimi i...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtua është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.